

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË "INFINITY ESTATES" SHPK
(ME ORTAK TË VETËM)**

KREU I

THEMELIMI, FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 1

THEMELIMI, FORMA DHE EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1 Sot më date 28/02/2024 themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **"INFINITY ESTATES" SHPK** (më poshtë e quajtur "Shoqëria").
- 1.2 Ky emërtim do të përdoret në të gjitha regjistrimet, transaksionet, marrëveshjet dhe komunikimet e saj me shtetin apo me të tretët dhe është i vlefshëm si jashtë dhe brenda vendit.
- 1.3 Shoqëria është person juridik shqiptar dhe vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 1.4 Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj identifikuese, në formën e përcaktuar nga Ortaku i vteëm i Shoqërisë
- 1.5 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe kanë karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga Mumin Selimi; Ndërtesa 51; Hyrja nr. 2; Ap. 10; Kodi postar 9403; Vlorë; Shqipëri.**
- 2.2 Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një Vendim të Asamblesë të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
- 2.3 Përveç veprimtarisë në nivel lokal, Shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, degëve, agjensive apo zyrave të perfaqesimit, brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar.
- 3.2 Në përputhje me këtë Statut, Shoqëria mund të mbyllë veprimtarinë e saj në çdo kohë dhe kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:



- a) Projektimin, ndërtimin e objekteve civile apo industriale dhe menaxhimin e zbatimit të këtyre projekteve për vete dhe për të tjerë;
 - b) Investimin në projekte zhvillimi zonash urbane, turistike, rezidenciale apo investime të çdo natyre në zhvillimin e pasurive të paluajtshme në përgjithësi;
 - c) Shitja e njësive të gjeneruara nga investimet në projektet e zhvillimit të pasurive të paluajtshme apo shitja e projekteve të zhvillimit në veçanti;
 - d) Administrimi dhe shfrytëzimi i njësive të gjeneruara nga investimet në projektet e zhvillimit në zonat e turizmit për qëllime rekreative, restauruese dhe akomoduese;
 - e) Vlerësim të pasurive të paluajtshme.
- 4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie apo transaksion tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe, ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.3 Aktivitetet e Shoqërisë, për të cilat kërkohet paraprakisht një leje, licensë, autorizim apo ndonjë akt tjetër miratues, do të ushtrohen pasi të jetë marrë akti në fjalë.

Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;

Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marreveshje të tjera me investitorë, bashkëinvestitorë, pronarë truallë apo objektësh, operatorë dhe administrues të strukturave turistike;

Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme që përfshijnë por pa u kufizuar në ato ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe të tjerëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

KREU II

KAPITALI, ORTAKU, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

NENI 5

KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1 Kapitali themelor i Shoqërisë është 100 000 (njëqindmije) Leke. Kontributi i Ortakut përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në Shoqëri është në raport me kontributin e tij dhe vlerën minimale e kuotës së tij, e cila llogaritet në raport me këtë kontribut, është 100 000 lekë; e paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë:

Nr	Emri i Ortakut	Kuota	Vlera (lekë)	Përqindja (%)
1	Fitim Imeraj	1	100 000	100
	Total	1	100 000	100



- 5.3 Kapitali mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.
- 5.4 Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga Ortaku i Vetëm që zotëron 100 % (njëqind për qind) të kontributeve në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6

ORTAKU I VETËM DHE KUOTAT

- 6.1 Shoqëria përbëhet nga një Ortak i Vetëm, me të dhënat e mëposhtëme:
Fitim Imeraj, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i lindur më 03/03/1978 në Vlorë i identifikuar me letërnjoftim ID nr.032589878 dhe nr.personal H80303103A , i cili zotëron 100 % (njëqind për qind) të kapitalit;
- 6.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë zotëron një kuotë në masën 100% me vlerë 100 000 (njëqindmijë) lekë

NENI 7

MËNYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

- 7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë e të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- Kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Çdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.
- 7.2 Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.
- 7.3 Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës.
- 7.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakort në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshirë këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.
- 7.5 Kuotat që shiten kanë vlerën fillestare të regjistrimit të kapitalit fillestar, nëse Shoqëria deri në momentin e fillimit të procedurës së shitjes nuk ka bërë rritje kapitali sipas ligjit dhe të regjistruar në QKB, me përjashtim të rastit kur palët bien dakort për një vlerë më të lartë.
- 7.6 Vendosja e çfarëdo lloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e shprehur me anë të Vendimit të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

NENI 8

PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE, PJESËTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

- 8.1 Personi që kalon kuotën dhe ai që e përfiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri ne çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të nenit 74 të Ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.
- 8.2 Shoqëria realizon kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË

NENI 9

ASAMBLEJA E ORTAKUT TË VETËM

- 9.1 Asambleja e Ortakut të Vetëm është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht, por pa u kufizuar, çështjet e mëposhtëme:
- Përcaktimin dhe mbikëqyrjen e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - Ndryshimet e Statutit;
 - Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
 - Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themelor të Shoqërisë;
 - Riorganizimin, prishjen dhe likuidimin e Shoqërisë;
 - Miratimin e strukturës së Shoqërisë dhe nivelet e pagave për vend pune;
 - Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
 - Miratimin e marrjes së kredive bankare;
 - Shndërrimin e formës së Shoqërisë dhe/ose bashkimin me shoqëri të tjera, apo pjesëmarrjen në shoqëri apo grupe shoqërish;
 - Miratimin e rregulloreve të ndryshme të punës si dhe të tjerave që në thelb kanë të bëjnë me procese të rëndësishme të veprimtarisë së Shoqërisë;
 - Përfaqësimin e Shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - Çështje të tjera të parashikuara nga Ligjet në fuqi apo nga ky Statut.
- 9.2 Në QKB duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm për:
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - Investime;
 - Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - Vendime të tjera që Asambleja e Ortakut të vetëm vlerëson se duhen regjistruar.
- 9.3 Të gjitha Vendimet e Asamblesë së Ortakut të Vetëm ruhen në një regjistër të veçantë, sipas numrit dhe datës. Administraori përgjigjet për rregullsinë e regjistrit. Vendimet e paregjistruara në Regjistrin e Vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund ti kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur Shoqëria provon se i tretit ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të kishte pasur dijeni për të.

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët emërohen nga Asambleja e Ortakut të Vetëm për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtë ripërtëritje. Asambleja e Ortakut të Vetëm merr vendim të posaçëm për riemërimin e Administratorit pas periudhës së emërimit të parë.



- 10.2 Administratori do të përfaqësojë Shoqërinë dhe do të jetë ligjërisht përgjegjës për aktivitetet e Shoqërisë. Ai do të manaxhojë dhe drejtojë veprimtarinë e përditshme të Shoqërisë duke siguruar që manaxhimi të bëhet në mënyrë të ligjshme dhe në interes të Shoqërisë. Duke qenë përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, administratori ka të drejtën të nënshkruajë aktet dhe dokumentet e Shoqërisë, përfshirë hartimin e të gjitha vendimeve të Shoqërisë.
- 10.3 Caktimi i Administratorit bëhet nga ky statut për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë riemërimi nga Ortaku i Vetëm. Administrator i Shoqërisë caktohet Z.Fitim Imeraj, shtetas shqiptar, madhor me zotësi juridike për të vepruar, i lindur më 03/03/1978 në Vlorë i identifikuar me letërnjoftim ID nr.032589878 dhe nr.personal H80303103A.
- 10.4 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare;
 - përfaqësojë Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, personalisht ose me përfaqësim, tek palët e treta, institucione apo entitete publike ose private;
 - kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
 - mbajë një regjistër të veçantë për regjistrimin e të gjitha Vendimeve të Ortakut të Vetëm;
 - lidhë kontratat e punës me punonjësit e Shoqërisë;
 - mbajë korrespondencë të rregullt me të tretët, si dhe të marrë të gjitha masat që kjo të jetë e arkivuar në arkivën e Shoqërisë;
 - përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për QKB;
 - kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj apo në këtë statut.

NENI 11

SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

Asambleja e Ortakut të Vetëm përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.

KREU IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, HUMBJET DHE FITIMET

NENI 13

- 13.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- 13.2 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) shqyrtohen dhe miratohen nga Ortaku i Vetëm, dhe paraqiten nga Administratori në organet tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit të ardhshëm.
- 13.3 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së vitit financiar, pas pagimit të detyrimeve, i kalojnë Ortakut të Vetëm.
- 13.4 Humbjet e Shoqërisë do të mbulojnë deri në kufirin e kapitalit themelor dhe Ortaku do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themelor të Shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e vitit financiar të parë deri në tre vitet pasardhës.

NENI 14

EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR

- 14.1 Ortaku mund të emërojë një ose më shumë ekspertë kontabël të autorizuar në përputhje me dispozitat e Ligjeve në fuqi.
- 14.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike-tregtare të Shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është i ngarkuar dhe i ka kryer këto duke qenë i ngarkuar nga Ortaku.
- 14.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit vjetor dhe për kontrollet periodike të ushtruara, raporte këto të cilat është i detyruar ti paraqesë dhe ti dorëzojë në kohë Ortakut për ti shqyrtuar dhe miratuar mbi bazën e të drejtës së tij vendimmarrëse.

KREU VI

PRISHJA - LIKUIDIMI, RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 15

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 15.1 Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar prishet:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me hapjen e procedurave të falimentimit ;
 - c) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare
 - d) në raste të tjera të parashikuara në statut;
 - e) në raste të tjera të parashikuara në ligj;
 - f) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Ortakut të Vetëm.
- 15.2 Në këtë rast Asambleja e Ortakut të Vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likuidimit të Shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 15.3 Prishja e Shoqërive Tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 15.4 Administratori ka detyrë të regjistrojë shpërbërjen e Shoqërisë pranë QKB si dhe të kryejë të gjitha procedurat deri në përfundim të këtij procesi për aq kohë sa kjo dispozitë e statutit nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

NENI 16

PROÇEDURA E SHNDËRRIMIT

- 16.1 Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore me miratimin e Ortakut, nëpërmjet shndërrimit sipas procedurës së parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare
- 16.2 Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet që Shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve. Marrëdhëniet e brendëshme në fushën e manaxhimit dhe administrimit të Shoqërisë midis administratorit, ortakut, dhe çdo të punësuarit në Shoqëri, do të rregullohen me anën e një rregulloreje të miratuar nga Ortaku.
- 16.3 Shndërrimi njoftohet për regjistrim pranë QKB në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 17

DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

- 17.1 Për çdo gjë që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut që lidhet me funksionimin e Shoqërisë, zbatohet ligjislacioni shqiptar në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij statuti.
- 17.2 Në çdo rast kur legjislacioni shqiptar përkatës mund të ndryshojë, ky statut me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm, sipas rregullave të përcaktuara mund të ndryshohet, në përputhje me ndryshimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.
- 17.3 Ky akt themelimi dhe statut hartohet në 3 (tre) kopje origjinale dhe hyn në fuqi për palët nënshkruese nga data e nënshkrimit të tij dhe prodhon efekte ndaj të tretëve nga data e regjistrimit të tij në QKB.

**ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"INFINITY ESTATES" SHPK**

FITIM IMERAJ

